

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“FLUFFY” SH.P.K**

Sot, më datë 13/09/2022 (dy mijë e njezet e dy),

1. **Kevin Toptani, me atesi Rrajmond**, shtetasi shqiptar, i ditëlindjes 28/07/2000, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rruga “ Hil Mosi”, shtëpi private nr 2, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes me numer id K00728070N.

2. **Xhejson Hidri me atesi Ylli** shtetas Shqiptar, i ditëlindjes 06/06/2001 lindur në Tiranë dhe banues Tiranë në rruga “Aleksander Moisiu” vila 17, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes me numer id K10606060J.

Vendosem të themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe në përputhje me dispozitat vijuese.

**NENI 1**  
**Themelimi**

Emri i shoqërisë është “**FLUFFY**” Sh.P.K, në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve, si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri “**FLUFFY**” SH.P.K, sipas përcaktimeve të bera në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

**NENI 2**

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë. Shoqëri Fitimpruese .

Qëllimi i krijimit të kësaj shoqërie është fitimpruese. Ajo do të zhvillojë veprimtarinë e saj në: Kërkim në të gjithë sektorët për klientet për interes të paleve të treta. Krijimi dhe menaxhimi i website të internetit dhe fushatave web. Kërkim i klienteve nëpërmjet aktiviteteve të thirrjeve në llogari të veta dhe e paleve të treta. Shërbime tregtare, analiza tregu, dërgimi i listave të politikave dhe fushatave marketingu sms dhe mesazhet e menaxhimit të fushatës së reklamave në përgjithësi në emer dhe për të treta. Organizimet e takimeve si online edhe fizike. Aktivizimet e Franchising dhe aktivitete direkte. Sjellja e sa me shumë turistëve duke njohur bizneset shqiptare të të gjitha kategorive. Berja e një database të bizneseve shqiptare.. Konsultime për plan marketingu të përgjithshëm. Aktivitete që synojnë realizimin e takimeve ndërpersonale. Organizimi i ngjarjeve, konferenca aktivitetet e organizimit të udhëtimit. Agjensi imobiliare, ndërmjetësim për pasuritë e patundshme dhe financiare. Cdo operacion të ngjashëm dhe të lejuar nga legjislacioni privat

**NENI 3**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “ **FLUFFY** ” SH.P.K. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë është: : Prodhim dhe tregtim të produkteve të Kreperise në pika të ndryshme Kreperie. Krijimi i rrjeteve të Kreperise brenda vendit .

Studim projektim te platformave; Te lidhe kontrata me subjekte publike dhe private te lejuar nga legjislacioni ne fuqi. Gjithashtu pika me e rendesishme e objektit te kesaj shoqerise eshte SEKTORI I TURIZMIT, ku nenkuptohet Turizmi I Huaj dhe ai vendas (shqiptar), Hotelerise, Kultures, Historise, Bukurive Natyrore, Siteve Arkeologjike, Bareve, Restoranteve, Biznesit.

#### NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në Bashkinë Tirane, Adresa :Selia e shoqerise ndodhet në Bashkinë Tirane. rruga "Murat Toptani ",brenda pazarit te vjeter i Tiranes, ne zn 8150 me nr pasurie 1/86. duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

#### NENI 6 Kapitali i Shoqërisë dhe Ortaket

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100000 (nje qind mije) leke, Ortaket themelues **z. Kevin Toptani, z Xhejson Hidri** za te Shoqërisë Tregtare "FLUFFY" SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- **1 Kevin Toptani**, me atesi Rrajmond shtetas Shqiptar, i ditëlindjes 28/07/2000, lindur në Tirane , dhe banues ne Tirane rruga Hil Mosi, mbajtës i kartes me numer K00728070N zoterues i 50 % te kuotave te perbere nga 50000( peseqind mije) leke duke perfaqesuar 50 % te kapitalit.

- **4 Xhejson Hidri me atesi Ylli** ,shtetas shqiptare e datelindjes 06/06/2001 lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane rruga Aleksander Moisiu vila 17, mbajtes i kartes se identitetit me numer id K10606060J, zoterues i 50 % te kuotave te shoqerise te perbere nga 50000 pese qind mije )leke duke perfaqesuar 50 % te kapitalit.

Pergjegjesia e ortakeve shtrihet deri ne shumen e kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar .

#### NENI 7 Organët Drejtuesë

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;  
Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

#### NENI 8 Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërisë do të jetë **Z. Kevin Toptani**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 28/07/2000, lindur në Tirane), dhe banues ne Tirane, Rruga Hil Mosi, mbajtës i kartes me numer K00728070N.

#### NENI 9

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### NENI 10





Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### NENI 11

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### NENI 13

Mosmarreveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkruan pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 6 kopje në gjuhën shqipe.

### ORTAKËT THEMELUES

**Kevin Toptani**

Kevin Toptani  


**Xhejson Hidri**

Xhejson Hidri  
